




OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

**Raport studimor
“Buxhetimi për fëmijë” për vitin 2012 - Qarku Lezhe**



QARKU LEZHE

Eksperte Rajonale
Gentiana Neçaj
Prill 2014

Lista e shkurtimeve

Observatori	- Observatori për të Drejtat e Fëmijëve Lezhe
ACA	- Aleanca për Fëmijët në Shqipëri
UNICEF	- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
NJDF	- Njësia për të Drejtat E fëmijëve
NJMF	- Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
MASH	- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
DAR	- Drejtoria Arsimore Rajonale
ZA	- Zyra Arsimore
MB	- Ministria e Brendshme
PAK	- Personat me aftësi të kufizuara
OBSH	- Organizata Botërore e Shëndetësisë

I. Parathënie dhe falënderime

“Observatori për të Drejtat e Fëmijës” është një iniciativë e UNICEF –Albania ,i cili ka me shume se tre vjet që vepron në Shqipëri. Tashmë zyrat e Observatorit janë të ngritura në të gjitha qarqet e vendit .

Ne qarkun e Lezhës zyra e Observatorit funksionon që prej shtatorit te 2011,e cila ashtu si të gjitha zyrat ne vend harton raporte bazuar në realizimin e të drejtave të fëmijës me shtrirje gjeografike në të gjithë territorin e Shqipërisë, duke u mbështetur në analizën e 140 treguesve të ndryshëm.

Zyra e Observatorit që ka ngritur mekanizmin për mbledhjen e informacionit, monitorimin dhe studimin e situatës së realizimit të të drejtave të fëmijëve në nivel rajoni.

Observatori për të drejtat e fëmijëve Lezhë ka një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh publikë dhe jopublikë.

Arritjet në nivel lokal konsistojnë në kontributin e Observatorit Lezhë në mbledhjen e të dhënave, të cilat u përpunuan në formë elektronike të të dhënave të Observatorit (www.observator.org.al). Observatori për të drejtat e fëmijëve Lezhe ka marrë pjesë aktivisht dhe ka dhënë kontributin e tij të rëndësishëm ne hartimin e Strategjisë rajonale për fëmijët 2013-2015 Lezhe.

Përveç mbledhjes së treguesve të të drejtave të fëmijëve në sektorë të ndryshëm, si: arsim, shëndetësi, punësim, ndihmë ekonomike, pjesëmarrje të fëmijëve, Observatori ndërmori nismën e realizimit të një studimi rajonal lidhur me temën e buxhetimit të fëmijëve për vitin 2012.

Për realizimin e këtij studimi, falënderoj për bashkëpunimin institucional, aktorët e rëndësishëm vendorë, si: Këshilli i Qarkut-Lezhë (Drejtoria e Shërbimeve të Përkujdesjes Shoqërore), Institucionet Arsimore dhe Shëndetësore, Zyrën rajonale të Shërbimit Social Shtetëror – Lezhë.

Një falënderim i veçantë i dedikohet UNICEF, që është mbështetja financiare për realizimin e këtij studimi. Mbështetja më e rëndësishme humane dhe profesionale ka ardhur nga Znj. Elma Tershana (drejtoreshë e projektit) nga zyra qendrore e Observatorit për të drejtat e fëmijëve në Tiranë. Një falënderim shkon dhe për Znj. Mina Mata (Administratore Kombëtare për të dhënat), për mirëkuptimin dhe mbështetjen që ka dhënë gjatë realizimit të studimit.

Falënderime të përzemërta!

II.Hyrja

Studimi i buxhetimit për fëmijë është një nismë e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve, e cila është realizuar në qarkun e Lezhës për vitin 2012.

Qëllimi i studimit është analizimi dhe krahasimi i tendencave të buxhetimit për fëmijë në sektorët: arsim, shëndetësi, ndihmë ekonomike, pjesëmarrje nga fondet buxhetore të pushtetit qendror si edhe nga fondet buxhetore të qeverisjes vendore. . Studimi analizon buxhetimin në vitin 2012 si edhe bën krahasimin e fondeve buxhetore në total kundrejt fondeve të planifikuara dhe shpenzuara për fëmijë.

Buxhetimi është një çështje që kërkon vëmendje të veçantë, në mënyrë që fondet e alokuara nga pushteti qendror dhe të përpiluara nga pushteti vendor të jenë sa më konform nevojave dhe prioriteteve të këtij rajoni.

Metodologjia:

Për realizimin e studimit të buxhetimit në nivel rajonal, jemi bazuar në:

- a) *Desk – Review* e cila përfshin rishikimin e dokumenteve, raporteve, ligjeve, studimeve kombëtare; Dokumentet që janë përdorur për realizimin e këtij studimi janë:
 - Programi buxhetor i arsimit bazë, i mesëm i përgjithshëm dhe profesional;
 - Programi buxhetor për shërbimet e kujdesit parësor dhe publik;
 - Ligji nr. 10355 datë 2.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”;
 - Projekt - buxheti 2011- 2013;
 - Relacion i projekt - buxhetit faktik 2012;
 - Udhëzimi i zbatimit të buxhetit 2011;
 - Buxhetimi me pjesëmarrje,udhëzues për pushtetin - vendor në Shqipëri.

- b) *Mbledhje informacionit/ të të dhënave* në lidhje me buxhetimin nga pushteti qendror dhe ai vendor, si dhe informacioni sasiorë i përcjellë nga Dega e Thesarit - Lezhe

Ky studimi është realizuar duke u bazuar në disa **prioritete dhe burime** të cilat kryesisht janë:

- të dhënat cilësore për prioritetet e nevojave të fëmijëve si edhe rëndësisë që ata zënë ose jo në buxhetimin qendror dhe vendor
- të dhënat sasiorë nëpërmjet institucioneve përkatëse për fondet buxhetore të pushtetit qendror dhe pushtetit të qeverisjes vendore për vitin 2012 në qarkun e Lezhës ;
- të dhënat e fondeve buxhetore në total nga pushteti qendror për sektorët: arsishëndetësi, ndihmë ekonomike, aftësia e kufizuar, shpenzime personeli;
- llogaritja sipas koeficienteve dhe formulave të gatshme të buxhetit qendror për fëmijë në secilin sektorë;
- informacione në lidhje me fondet buxhetore të qeverisjes vendore për: arsim, qendra sociale, art kulturë dhe sport, për shpenzime personeli në njësitë vendore;
- llogaritja sipas koeficienteve dhe formulave të gatshme të buxhetit vendor për fëmijë në secilin sektorë;

- krahasimi i fondeve buxhetore në total midis fondeve të planifikuara dhe atyre të realizuara .

Ky studim mund t'i shërbejnë institucioneve arsimore, shëndetësore, të mbrojtjes sociale dhe njësive vendore nëpërmjet gjetjeve dhe rekomandimeve të tij në përmirësimin e politikave buxhetore për tu ardhur sa më shumë në ndihmë fëmijëve dhe të ardhmes së tyre .

Përshkrimi i buxhetimit

Hartimi i buxhetit realizohet mbi politika dhe programe të veçanta. Në këtë mënyrë buxheti i vitit 2011 është hartuar mbi bazë të ligjit nr 10355 datë 2.12.2010 “Për Buxhetin e vitit 2011”. Buxhetimi lidhet me dokumente të ndryshëm strategjikë si: programi buxhetor, shërbimet e kujdesit parësor dhe publik, programi buxhetor i arsimit bazë, i mesëm i përgjithshëm dhe profesional, si dhe buxhetimi me pjesëmarrje, ku Bashkia e Tiranës është një nga bashkitë pilot ku po zbatohet kjo praktikë.

Partnerët në buxhetim përfshijnë jo vetëm fondet buxhetore të alokuara nga pushteti qëndror por edhe donatorë të ndryshëm.

III. Analiza e të dhënave.

Qarku i Lezhës shtrihet në veriperendim të Shqipërisë dhe ka në përbërjen e tij 21 njësi vendore nga të cilat 17 komuna dhe 4 bashki. Qarku i Lezhës në vitin 2012 numëron një popullsi prej 214,432 banorë¹, nga të cilët rrethi Lezhë ka edhe numrin më të lartë të banorëve, duke u pasuar nga rrethi Laç dhe në fund nga rrethi i Mirditës. Ky studim ka në fokus të tij si grup kryesor fëmijët, (mosha 0-18 vjeç), ndërsa numri i fëmijëve (mosha 0-18 vjeç), në qarkun e Lezhës për vitin 2012 është 60,536² fëmijë, me kokretisht Rrethi Lezhë me 28,432 fëmijë, ndjekur nga rrethi I Kurbinit me 21,364 fëmijë, dhe në fund rrethi I Mirditës me 10.349 fëmijë.

Bazuar në të dhënat e Shërbimit Social Shtetëror qarku I Lezhës ka 56.546 familje prej të cilave 5481 familje marrin ndihme ekonomike dhe në përbërjen e tyre kanë fëmijë të moshës 0-18 vjeç, e perkthyer në përqindje 9.69% e familjeve . Vlera totale në lekë që këto familje kanë përfituar gjatë vitit 2012 është 764.921.230 lekë³, në formën e ndihmës ekonomike (Burimi Shërbimi Social Shtetëror).

Një problem i cili është vënë re nga punonjësit e ndihmës ekonomike është fakti që shumë persona janë të regjistruar me pa të drejtë në skemën e ndihmës ekonomike dhe shumë të tjera

¹ Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, MB, Tiranë Korrik 2013.

² Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, MB, Tiranë Korrik 2013.

³Zyra Rajonale SHSSH Lezhë Dhjetor 2013

në varfëri absolute kanë mbetur jashtë saj , ndaj po bëhet nje rivlerësim për të gjitha familjet përfituese.

Të drejtat e fëmijëve në vëmendjen lokale.

Të drejtat e fëmijëve janë ligjëruar dhe mbrohen sipas ligjit numër 10 347, datë 4. 11. 2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, i cili i vjen në mbrojtje të gjithë fëmijëve me shtetësi shqiptare, që ndodhen brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Të drejtat e fëmijëve, jo vetëm që duhet të ekzistojnë në parim, por duhet të marrin edhe mbështetjen e duhur nga mekanizmat institucional në nivel qendror dhe vendor, të përcaktuara nga ligji. Në qarkun e Lezhës është ngritur dhe funksionon që nga viti 2011 Njësia për të Drejtat e Fëmijëve (NJDF). Ndërsa përsa iu përket njësive vendore nje pjesë e vogël e tyre kanë ngritur NJMF , e konkretisht:

Njësia Vendore	NJMF
Lezhë	+
Balldre	+
Blinisht	-
Kallmet	-
Dajç	-
Shënkoll	-
Shëngjin	-
Zejmen	+
Kolsh	+
Ungrej	-
Laç	+
Mamurras	+
Milot	+
Fushë Kuqe	-
Rrëshen	+
Rubik	+
Fan	-
Orosh	+
Kaçinar	-
Kthellë	-
Selitë	-
Qarku Lezhë	+

Tabela 0.1. Komunat dhe bashkitë e qarkut të cilat kanë ngritur NJMF.

Burimi : Observatori Lezhë

Nga 21 njësi vendore vetem 9 prej tyre e kanë ngritur NJMF. Në këto njësi NJMF ka qënë shumë funksionale duke evidentuar shumë raste dhe duke i referuar pranë organeve kompetente për zgjidhje pasi zoterojne kapacitete profesionale per referim te rasteve.

Këto mekanizma bashkëpunojnë edhe me institucionet e tjera publike si edhe me aktorët e shoqërisë civile me fokusin e mbrojtjes së fëmijëve dhe të drejtave të tyre.

IV. Përshkrim i përgjithshëm i situatës së të drejtave të fëmijëve në nivel Qarku

Qarku i Lezhës shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë dhe ka në perberjen e tij 21 njësi vendore nga të cilat 17 komuna dhe 4 bashki.

Qarku i Lezhës në vitin 2012 numëron një popullsi prej 214,432 banorë², nga të cilët rrethi Lezhë ka edhe numrin më të lartë të banorëve, duke u pasuar nga rrethi Laç dhe në fund nga rrethi i Mirditës. Ky studim ka në fokus të tij si grup kryesor *fëmijët*, (mosha 0-18 vjeç), ndërsa numri i fëmijëve (mosha 0-18 vjeç), në qarkun e Lezhës për vitin 2012 është 60,536² fëmijë, me kokretisht Rrethi Lezhë me 28,432 fëmijë, ndjekur nga rrethi I Kurbinit me 21,364 fëmijë, dhe në fund rrethi I Mirditës me 10.349 fëmijë.

Bazuar në të dhënat e Shërbimit Social Shtetëror qarku I Lezhës ka 56.546 familje prej të cilave 5481 familje marrin ndihme ekonomike dhe në përbërjen e tyre kanë fëmijë të moshës 0-18 vjeç, e perkthyer në përqindje 9.69% e familjeve . Vlera totale në lekë që këto familje kanë përfituar gjatë vitit 2012 është 764.921.230 lekë³, në formën e ndihmës ekonomike (Burimi Shërbimi Social Shtetëror).

Një problem i cili është vënë re nga punonjësit e ndihmës ekonomike është fakti që shumë persona janë të regjistruar me pa të drejtë në skemën e ndihmës ekonomike dhe shumë të tjera në varfëri absolute kanë mbetur jashtë saj , ndaj po bëhet një rivlerësim për të gjitha familjet përfituese.

² Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, MB, Tiranë Korrik 2013.

² Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile, MB, Tiranë Korrik 2013.

³Zyra Rajonale SHSSH Lezhë Dhjetor 2013

V.Aksesi ndaj buxhetimit

Republika e Shqipërisë pas ratifikimit të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, ka ndërmarrë shumë nisma për realizimin e reformave gjithëpërfshirëse me synimin e përforcimit të mirëqenies dhe interesit më të lartë të fëmijës. Qeveria në çdo fundvit harton dhe miraton buxhetin për vitin pasardhës, i cili është i specifikuar në zëra të veçantë. Përlllogaritja e buxhetit që shkon për fëmijët është kompleks dhe realizohet në saj të formulave të gatshme, të koeficienteve duke u bazuar në Institucionet qendrore dhe programe buxhetore përkatëse:

- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës me programet buxhetore “Arsimi Bazë” dhe “Arsimi i Mesëm i përgjithshëm dhe profesional”;
- Ministria e Shëndetësisë, me programet buxhetore ”Shërbimet e kujdesit parësor” dhe “Shërbimet e kujdesit publik”;
- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me programet buxhetore : “Mbrojtja sociale” dhe “Shanset e barabarta”;
- Zëri “Shpenzime buxhetore për personelin” për të gjithë buxhetin qendror.

Gjithashtu për përlllogaritjen e buxhetit për fëmijë duhen analizuar fondet buxhetore të qeverisjes vendore për arsim, qendra sociale, art, kulturë, sport dhe shpenzimet për personelin e çdo njësie vendore. Për të përcaktuar buxhetin për fëmijë në qarkun e Lezhës, krahas informacionit mbi fondet buxhetore të buxhetit qendror dhe vendor, përlllogaritet edhe raporti i fëmijëve nga numri total i popullsisë së Qarkut Lezhë si dhe numri i familjeve dhe i fëmijëve. Me anë të përlllogaritjes së këtyre treguesve, pasi vendosen koeficientet e duhur, përlllogaritet buxheti për çdo fëmijë.

Në tabelën e mëposhtme, paraqiten të dhëna demografike në qarkun Lezhë për vitin 2012:

	Nr.fëmijëve	Nr.popullsisë	Nr.fëmijëve/ Nr.popullsisë (%)	Nr.familjeve	Nr.fëmijëve/Nr.familjeve
A	B	C	d=b/c	E	f=b/e
Qarku Lezhë	60536	214432	28.23 %	56546	107.05%
Lezhë	28823	104362	27.61 %	26604	108.34%
Laç	21364	72665	29.40 %	19290	110.75%
Mirditë	10342	37405	27.64 %	10652	97.15%

Tabela 0.2: Numri i fëmijëve dhe raporti me numrin total të popullsisë dhe familjet për vitin 2012 për Qarkun Lezhë;

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, MB, Tiranë Korrik 2013.

2. Buxheti qendror

2.1 a) Shpenzimet buxhetore qendrore për zhvillim dhe arsim

Shpenzimet buxhetore për arsimin parauniversitar nga pushteti qendror, janë fonde nga të cilat fëmijët përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi përfshin shpenzime korrente dhe investime në institucione ku përfitues janë fëmijët.

Në tabelë pasqyrohen shpenzimet korrente dhe investimet për fëmijët në vitin 2012:

Tabela 0.3: Buxheti për vitin 2012 për arsimin e detyruar për Rrethin Lezhë, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit (Lezhë), DAR Lezhë,

	Shpenzime korrente (000 lekë)	Investime (000 lekë)	Totali (000 lekë)	Nr.fëmijëve në shkolla	Buxheti për fëmijë (000 lekë)
A	b	C	d=b+c	E	f=d/e
Rrethi Lezhë	380950	20674	59 624	12 051	49.47%

Tabela 0.4: Buxheti për vitin 2012 për arsimin e Mesem për Rrethin Lezhe, (në 000 lekë).

Burimi: Dega e Thesarit (Lezhë), DAR Lezhë,

	Shpenzime korrente (000 lekë)	Investime (000 lekë)	Totali (000 lekë)	Nr.fëmijëve në shkolla	Buxheti për fëmijë (000 lekë)
A	b	C	d=b+c	E	f=d/e
Rreth Lezhë	92416	15348	107764	3809	28.29%

A	b	C	d=c/1.5	e=d*4.2	f= d*2.2	g= (b/e)*f	h=g/f
2012	360818	820	1230	5166	2706	1 188 999	439.393

Në rrethin e Leshës buxheti që shkon për fëmijët nga buxheti i qeverisjes vendore është 439.393⁴ leke.

VI. a) Buxhetimi me pjesëmarrje

1.1 Buxhetimi me pjesëmarrje të gjerë është një mekanizëm, i cili u mundëson qytetarëve që të marrin pjesë në vendimmarrje në menaxhimin e të gjitha, ose të një pjese të burimeve aktive të financave publike të pushtetit lokal. Buxhetimi me pjesëmarrje ka për qëllim rritjen e transparencës, përgjegjësisë dhe përfshirjen sociale në qeverisje të çdo qytetari.

Buxhetimi me pjesëmarrje është një filozofi dhe praktikë e re pune, e cila mundëson afrimin e komuniteteve lokale me proceset vendimmarrëse lidhur me buxhetin publik. Kjo praktikë e re financiare ka potencialin që të rrisë pjesëmarrjen e zërit të qytetarëve përsa i përket vendimmarrjes rreth buxhetit si dhe për të ndihmuar qeverinë për të përmirësuar transparencën, efikasitetin dhe përgjegjësinë mbi buxhetin. Buxhetimi me pjesëmarrje mund të konsiderohet si një nga mjetet që do të forcojë edhe më shumë procesin e duhur të decentralizimit në Shqipëri.

b) Përfitimet potenciale të buxhetimit me pjesëmarrje

Rritja e efektivitetit në targetimin e buxhetit: Në shumë raste, buxhetet publike nuk reflektojnë prioritetet reale të qytetarëve, sidomos të të varfërve. Burimet publike të pakëta janë shpenzuar shpesh në mënyrë të gabuar ose për grupe përfituesish të gabuar.

Përmirësimi i transparencës dhe përgjegjshmërisë: Qytetarët shpesh nuk kanë akses tek informacioni mbi buxhetin i qeverisë. Në disa raste qytetarët i perceptojnë buxhetet si tepër komplekse për t'i kuptuar totalisht. Nxitja e përfshirjes sociale, pakësimit të varfërisë dhe fuqizimit:

Procesi tradicional i buxhetit kontribuon shpesh në mospërfshirje sociale dhe varfëri si rezultat i kapjes së elitave, lobeve dhe interesave të fuqishme. Duke përfshirë zërin e qytetarëve të zakonshëm si dhe të grupeve më të papërkrahura, qeverisja mund të ridrejtojë fuqishëm investimet publike drejt shërbimeve bazë për lagjet e varfra

Në Shqipëri eksperiencia sapo ka lindur dhe është ende në një fazë zhvillimi. Buxhetimi me Pjesëmarrje nuk duhet parë si zgjidhja e të gjitha problemeve të qeverisjes vendore. Ai më tepër është plotësues i mekanizmave tradicionalë të sektorit publik të përgjegjshmërisë politike,

I. *Rekomandime*

- Vënia e çështjes së buxhetimit për fëmijë në fokus të agjendës së pushtetit lokal.
- Rekomandohen njësitë vendore që të zbatojnë rigorozisht ligjin për taksat vendore, me qëllim që të mbledhin të gjithë taksat vendore përkatëse, për një rritje efektive të buxhetit të tyre, me qëllim që të kenë sa më shumë fonde në dispozicion për zbatimin e programeve të ndryshme lokale.
- Rekomandohen njësitë e pushtetit vendor që të shfrytëzojnë mundësitë dhe burimet alternative për të maksimizuar të ardhurat e tyre vendore, në mënyrë që realizimi i projekteve dhe nismave të ndryshme lokale të mos jetë i kushtëzuar vetëm nga grantet e pushtetit qendror.
- Ngritja, fuqizimi dhe trajtimi i mekanizmave mbrojtës dhe referues të të drejtave të fëmijëve (NJDF dhe NJMF) si pjesë e një zinxhiri të pandarë për implementimin korrekt dhe maksimal të politikave sociale.
- Në përputhje me ligjin në fuqi të decentralizimit, decentralizimi fiskal duhet të zgjerohet në shumë forma si; vetëfinancimi dhe zgjerimi i të ardhurave vendore nëpërmjet taksës së pronës etj.
- Rritja e fondeve buxhetore për fëmijë në sektorin e arsimit meqenëse fëmijët përfitojnë drejtë për drejtë. Një rritje e fondeve do të shtonte përpjekjet për përmirësimin e infrastrukturës shkollore dhe në rritjen e cilësisë. Gjithashtu një rritje të fondeve buxhetore duhet të ketë edhe në fushën e shëndetësisë, si edhe në skemën e mbrojtjes sociale.

Ø Bibliografia

- Buxhetimi me pjesëmarrje udhëzues për pushtetin vendor në Shqipëri (2006), Ekipi i Zhvillimit Social Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore .
- Ligji vjetor i buxhetit nr. 10355 datë 2.12.2011.
- Ligji nr.8379 datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 9355 datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 22, viti 2005, faqe 829.
- OBSH (2001), Deklaratë për Komitetin për të Drejtat e Fëmijës.
- Programi buxhetor “Arsimi bazë”, “Arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe ai profesional”.
- Programi buxhetor “Shërbimet e kujdesit parësor”, “Shërbimet e kujdesit publik”.
- Program buxhetor i MPCSShB “Mbrojtja sociale”, “Shanset e barabarta”.
- Projekt buxheti PBA 2011- 2013, Ministria e Financës, Drejtoria e përgjithshme e buxhetit.
- Politikat e përfshirjes sociale për fëmijët dhe financimi i tyre në Shqipëri Unicef.
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2004 -2015 e MASH-it, miratuar në 2004.
- Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar 2009-2013 e MASH-it, miratuar në Korrik 2009.